



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 19/07/2021 Ref.: 2800/21

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës dhe Manualit për Akreditim, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07 korrik 2021 mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” në nivel institucional, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024.
- II. Obligohet Universiteti të Gjakovës “Fehmi Agani” që deri më 15.11.2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti të Gjakovës “Fehmi Agani”, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional. AKA ka organizuar një vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universiteti të Gjakovës “Fehmi Agani”, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 04.02.2021 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Magdalena Platis dhe Christoph Back.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të Ekspertëve Ndërkombëtarë kanë hartuar raportet e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për riakreditim Institucional të Universiteti të Gjakovës “Fehmi Agani”- nga 11 fushat e standardeve të akreditimit, është vlerësuar se i përmbush plotësisht një (1) kapitull, substancialisht nëntë (9) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht një (1) kapitull.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07 korrik 2021 kanë shqyrtuar aplikacionin e Universiteti të Gjakovës "Fehmi Agani" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti të Gjakovës "Fehmi Agani";
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

